# DËSHMI ARKIVI

**A-395558**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nën vëzhgim nga Antidroga prej 2 javësh, si ra në pranga 20 vjeçari që porositi drogë në SHBA, teknika që përdorte me kartat e ID të humbura – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/nen-vezhgim-nga-antidroga-prej-2-javesh-si-ra-ne-pranga-20-vjecari-qe-porositi-droge-ne-shba-teknika-qe-perdorte-me-kartat-e-id-te-humbura/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 5 shtator 2026, 23:08:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 5 shtator 2026, 09:34:33 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c9bad299356ad6c4f750554496687ff922dc91f4c38b8fd6df836e99c8a9beb2` |
| TEKSTI | `3126af903340228960e30ea709c3a286ea440bab5ec170bc5575b10b8d0d93be` |
| PAMJA | `c33d1ddc7c14d0ab9648f895a1962fcccdbe378a60904714af09be902d361a5f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4e9c927255f1c985676fa23405a908116d4bc70fa4cb0bdf24a270848723b1cf` |
| E MËPARSHMJA | `e9a681600ef8a953771bf57db2dcb2aa24a29de9636669f41f065848384f811a` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4e9c927255f1c985676fa23405a908116d4bc70fa4cb0bdf24a270848723b1cf`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Ilustrim · Vizion Plus

*Nga Esido Barkaj*

Një tjetër operacion është finalizuar nga Antidroga e Tiranës ku është goditur një tjetër rast i trafikimit të lëndëve narkotike të nisura nga SHBA-të drejt vendit tonë.

Dorian Sinani, 20-vjeç është prangosur nga blutë e Tiranës si autori i dyshuar që ka porositur afro 5 kg kanabis me përqindje të lartë THC nga Amerika drejt Shqipërisë, drogë që më pas i riu do ta shiste në doza më të vogla.

Porosija e nisur nga kontinenti i largërt ishte ndarë në 8 pako në total.

Burime bëjnë me dije se Antidroga e Tiranës prej më shumë se 2 javësh e ka mbajtur nën vëzhgim të gjitha lëvizjet e Dorian Sinanit, autor i dyshuar për porositjen e kanabist me përqindje të lartë THC nga SHBA.

Mësohet se i riu ka marrë në një faqe në rrjetet sociale që denoncojnë karta e identitetit të humbura një nr ID të një qytetari tjetër dhe e kishte shënuar te porositja pakos me më shumë se 4 kg kanabis të porositur në SHBA. Madje dhe numrin e celularit kishte shënuar të një personi tjetër që nuk kanë lidhje me porositjen e drogës. Sinani është munduar që të përdorë të dhëna të rreme me qëllim që të mos identifikohej nga autoritet.

Lënda narkotike kishte si destinacion për tu dorëzuar në Shkodër. 20-

5 Viti i ri shkollor nis edhe në burgun e Korçës, 31 të dënuar ndjekin…

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

vjeçari është paraqitur para pak ditësh te posta në Shkodër, por nuk e ka bërë tërheqjen e pakos, pasi ka patur frikë.

Kanë qenë kamerat e sigurisë që kanë fiksuar lëvizjet e të riut prej disa ditësh që afrohej te pika e postës deri në momentin që Antidroga ka ndërhyrë për ta arrestuar. Në Shkodër kishte shkuar me taksi dhe përmes gjurmimit të taksisë është lokalizuar dhe banesa e tij në Bathore. Në fillimi i riu e pranoi se është autori i porositjes së drogës, por më pas në dëshmi e mohoi. I riu njihet si përdorues i lëndëve narkotike. Droga e porositur kapte vlerën gati 20 mijë euro në total në treg.

#droge #SHBA #Tirane

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



KRONIKË
**“Kam përjetuar tmerr”, ish-burri i...**
Xhuljana Zhuleku · Sot 00:04



KRONIKË
**“Testoi” policinë se ka vendosur bombë në...**
Xhuljana Zhuleku · Dje 19:44



KRONIKË
**Bojkoti i avokatëve shtyn gjyqet,...**
Xhuljana Zhuleku · Dje 18:47




© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.